



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:066434
Datë: 29.05.2024
Numri i dokumentit: 05748345

SCC- 10-0092
Paditësja

T H nga Gjilani, e përfaqësuar nga avokat I R nga Gjilani

Kundër

Të Paditurat

1. NPK Ujësjetësi i Qytetit “Hidroteknika” (emërtimi i tanishëm “Hidromorava”), Gjilan
2. Fondi Republikan i sigurimit shëndetësor – Njësia në Gjilan

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), sipas gjyqtarit Gazmend Sylaj, me 29 maj 2024 lëshon këtë:

A K T V E N D I M

1. Dhoma e Posaçme nuk ka kompetencë për vendosje kundër të paditurave.
2. Lënda kthehet për vendosje pranë Gjykatës Themelore në Gjilan.
3. Nuk caktohen shpenzime gjyqësore.

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Më 10 gusht 1995, pranë Gjykatës Komonale (tani gjykatës themelore) në Gjilan, paditësja ka parashtruar një padi nga marrëdhënia e punës.

Paditësja, me padi, kërkoj që të paditurat të obligohen lidhur me kthimin në vendin e saj të punës; kompensimin e të ardhurave personale për periudhën nga data 1 mars 1992 si dhe ti njihet e drejta në sigurimin pensional, invalidor dhe shëndetësor.

Me parashtrësën e datës 15 maj 2009, e paditura e parë me përgjigjen e saj në padi ndër të tjerash informon gjykatën se është transformuar në Kompani Rajonale për Ujë dhe Kanalizim “Hidromorava” SH.A. (shoqëri aksionare).

Pas disa seancave gjyqësore të zhvilluara, Gjykata Komonale në Gjilan (tani gjykata themelore), me aktvendimin e saj, C.nr.566/datë 16 mars 2010, shpallet jo kompetente dhe shkresat e lëndës i dërgon në DHPGJS, për vendosje .

Lënda pranë DHPGJS regjistrohet me 7 maj 2010.

Arsyetimi ligjor

Juridiksioni i DHPGJS

Sipas nenit 36 paragrafi 2.1, 2.2 dhe 2.3 të Ligjit për DHPGJS (Ligji Nr. 06/L-086) një kërkesë është e pranueshme nëse DHPGJS ka juridiksion në bazë të nenit 5 të Ligjit për DHPGJS dhe nëse parashtruesi ka të drejtë të nisë procedurat në mbështetje të paragrafit 1 të nenit 6 dhe paragrafit 2 të nenit 6 të Ligjit për DHPGJS.

Me paragrafin 2.3 të nenit 36 të Ligjit për DHPGJS (“pranueshmërinë e kërkesës” pranë DHPGJS) thuhet, citat se një kërkesë/ankesë është e pranueshme nëse: *“kërkesa/ankesa paraqitet kundër një pale që mund të jetë palë kundërshtare në procedurat para Dhomës së Posaçme, në mbështetje të paragrafit 2 të nenit 6 të Ligjit për DHPGJS”*.

Paragrafi 2.2 neni 6 i Ligjit për DHPGJS, parasheh se i paditur në procedurat pranë Dhomës së Posaçme, mund të jetë: *“në kuptimin e kërkesës së përcaktuar me nën-paragrafët 1.4 apo 1.5 të nenit 5 të këtij ligji: sipas zgjedhjes së Agjencisë, Ndërmarrja/Korporata në fjalë, apo Agjencia duke vepruar në emër të Ndërmarrjes/Korporatës në fjalë”*

Tutje sipas nenit 5 paragrafi 1.5.1 të Ligjit për DHPGJS (“Juridiksioni”) thuhet si në vijim: *“kërkesa që pretendojnë një të drejtë, titull apo interes në lidhje me, çfarëdo pasurie apo prone mbi të cilën Agjencia apo AKM-ja ka apo ka shpallur autoritetin administrativ”*

Sipas nenit 5.2, të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, thuhet se nëse një rregullore ose ligj që është në fuqi dhe që është shpallur nga një autoritet kompetent publik në Kosovë pas 10 Qershorit 1999 i cakton përgjegjësinë për administrimin e aseteve të përcaktuara në nën-paragrafi 1.2. të paragrafit 1. të këtij neni një organi tjetër publik, AKP nuk do të ketë autoritet mbi këto ndërmarrje duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të atij ligji ose rregullore.

Neni 3.1 i Ligjit nr. 03/L-087 mbi Ndërmarrjet Publike (NP) i ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-111 të datës 20 prill 2012 si dhe Ligji nr. 05/L-009 thotë se të gjitha Ndërmarrjet e radhitura në Listën 1 të bashkëngjitur këtij ligji janë NP qendrore. Çdo NP qendrore do të jetë në pronësi të Republikës së Kosovës. E paditura e parë (1) është NP Publike e radhitur në listën 1.

Lidhur me të paditurën e dytë (2), edhe pse nga shkresat e lëndës nuk vërehet ndonjë veprim procedural të ndërmarr nga gjykata themelore ndaj saj, gjykata konsideron se pasi që me padi është paditur edhe Fondi Republikan i sigurimit shëndetësor në rastin konkret edhe kjo e paditur nuk bie në juridiksion të DHPGJS.

Andaj nga gjitha arsyet e cekura DHPGJS nuk ka juridiksion mbi të paditurat dhe se lënda i kthehet për vendosje pranë Gjykatës Themelore në Gjilan.

Nga gjitha arsyet u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Shpenzimet gjyqësore

Pasi që çështja i është referuar, në këtë fazë, gjykata nuk cakton shpenzime gjyqësore për palët në këtë çështje.

Këshilla ligjore

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të DHPGJS brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për DHPGJS.

Gazmend Sylaj, Gjyqtar